



**NGRITJA  
E ZËRIT**

**Tel:** 044 195-113  
044 633-325  
**Adresa:** Rruga e UÇK-së,  
Skenderaj  
**Email:** info@ngritjaezerit.org  
**Web:** www.ngritjaezerit.org

GJYKATES KOMUNALE NE SKENDERAJ

**PADITES:** Ajet Kajtazi nga Runiku, 41000 Skenderaj, Republika e Kosovës

**E PADITUR:** REPUBLIKA E SERBISË –Qeveria e R.S. rr. e Nemanjës nr.11 11000 Beograd

### **PADI PER KOMPENZIM DEMI**

**Propozim për lirim nga pagimi i shpenzimeve procedurale** ( sipas nenit 7 te Udhëzimit Administrativ nga K.GJ. 2008/02 dhe neni 468.1 te Ligji Nr. 03/L-006)

**Objekt kontesti :** Kompensimi dëmit

**Vlera e kontestit :** 756 000 €

1. Paditësi nga forcat serbe është i rrahur dhe torturuar në Mitrovicë gjatë luftës në prani te anëtarëve te familjes, pastaj është dërguar ne stacionin policor në Mitrovicë ku është rrahur prapë brutalisht nga ana e policëve.

Provë : - Kërkesa për kompensim te demit nr. 580 – 1 e datës 22.12.2008

- Dëgjimi i dëshmitarëve; 1. Fetah Kajtazi nga fshati Klladernice dhe

2. Fadil Kajtazi poashtu nga fshati Klladernicë

2.) Paditësi si rezultati i veprimeve gjenocidiale, krimeve kundër njerëzimit te ndërmarra nga forcat ushtarake dhe policore të udhëhequra direkt nga qeveria e Serbisë ka pësuar dëme materiale dhe jo materiale , i është djegur-shkatërruar shtëpia me sipërfaqe prej 264 m<sup>2</sup> , dëmtim te kategorisë se V , interier shtëpiak duke e përfshire tekniken e bardhe me pajisjet përkatëse në sallon dhe mobilierin e te gjitha dhomave te gjumit, stallës ne sipërfaqe prej 48 metra katror , bagëtia (3 krerë lopë e 2 vjeta ) dhe nuk ka mundur ta punoj tokën për një periudhë kohore prej dy viteve .

Provë : Kërkesa për kompensimin e dëmeve te luftës , e dt. 22.12.2008, nr. 580 -1

Deklarata e për bashkësinë familjare me nr. rendor 000193 e dt. 12.01.2009

Vërtetimi i Drejtorisë së Urbanizmit nr. 325-510 i dt. 09.12.2008

Certifikata mbi te drejtat e pronës së paluajtshme UL – 72015062-00294 e dt.

15.12/08

3.) Viktimës nga forcat ushtarake policore serbe të udhëhequra direkt prej qeverisë se Serbisë e cila ka kryer veprime gjenocidiale , krime kundër njerëzimit,i është shkatërruar pasuria , është detyruar ta braktis vendbanimin se bashku me fëmijët ne kohë zgjatje prej

2 viteve për te mos ra ne duar te njësiteve policore-ushtarake serbe dhe ne duar te njësiteve tjera paramilitare.

Paditësi paraprakisht është larguar dhunshëm nga vendi i punës si drejtor i Qendrës parashkollore “Drita” ne Skenderaj me dt. 28.02.1992 , kurse me dt. 19.12.1998 është pensionuar ku edhe pse është pensionuar nuk e ka marr pensionin , kurse në vitin 2004 e merr pensionin nga institucioni kompetent në Kosovë .

Provë : - Kërkesa për kompensimin e dëmeve te luftës , e dt. 22.12.2008. , nr. 580 – 1

- Fletëparaqitja e të dhënave për evidencë për personat e siguruar – Enti i

Sigurimit në Mitrovicë (foto kopje)

- Libreza e punës e përmbyllur me 28.02.1992 (foto kopje)

Dëgjimi i paditësit dhe dëshmitarëve te propozuar si dhe provave te tjera te cilat paditësi do ti prezantoj ne seancat e shqyrtimit kryesor dhe ne rast nevojje te caktohet edhe eksperti përkatës

4.) Të drejtën për kompensim paditësi e bazon në nenin 185 te LMD ( G. Z. e RSFJ , Nr. 29 /78 ) në lidhje me nenin 180.1 te te njëjtit Ligj , me te cilin është paraparë që për demin e shkaktuar ndaj pasurisë te personave fizik si rezultat i dhunës dhe terrorit , përgjegjëse është ,, Bashkia shoqërore politike ” e në këtë rast e paditura Qeveria e Serbisë ka qen e obliguar te pengoj aktet e vrasjes , dhunës, terrorit , dëmtimit , asgjësimit dhe vjedhjes se pasurisë se paditësit .

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e te Drejtave dhe Lirive te Njeriut ( neni 1 Protokollin nr. 1 , neni 2 dhe protokollin nr. 6 , neni 3 , neni 5 ( 5 ) , neni 10 dhe neni 14 ) .

Paditësi propozon qe kjo Gjykatë të caktoj shqyrtimin kryesor te çështjes , t’i shfrytëzoj informatat e duhura nga mjetet provuese të propozuara dhe

1.) pastaj të bienë këtë :

## AKTGJYKIM

**I. Aprovohet** kërkesë padija e paditësit Ajet Kajtazi nga fshati Runik me vendbanim në f.sh. Runik , 41000 Skenderajt Republika e Kosovës në tersi si e bazuar .

**II. Obligohet** e paditura Republika e Serbisë respektivisht Qeveria e Serbisë si pasardhëse juridike e Qeverisë se me parshme qe ne emër te të njëjtës te kompensoj demin material dhe jo material paditësit Ajet Kajtazi me vendbanim në Runik , 41000 Skenderajt Republika e Kosovës, duke ja paguar :

- shumen prej 20 000 €për rrahje dhe torturë çnjerëzore
- shumen prej 158 400 €për dhembjen shpirtërore dhe te munduarit , ndjekjes nga shtëpia , banimi ne qiell te hapur dhe shtëpi te huaja gjatë dy viteve
- shumen prej 70 000 për shkak te pamundësuarit e krenimit te festave fetare ne shtëpi, vizitën dhe nderimin e varrezave , humbjes se kontaktit me farefis dhe te afërmit
- shumën prej 37 912 €për dëbim nga vendi i punës, për 7 vjet e 10 muaj
- shumën prej 6750 € për mos dhënien te pensionit nga 9.03.1999-2004
- shumen prej 396000 €për shtëpinë e djegur – shkatërruar
- shumen prej 21 600 €për stallë,bagëti , hamar me drithë dhe koshin e misrit
- shumen prej 9850 €për traktorin e vjedhur me gjithë pjesët përcjellëse
- shumen prej \_\_\_\_\_ €për pamundësimin e shfrytëzimit te tokës bujqësore për tri vite.

te gjitha këto shuma me kamat ligjore qe nga dita e ngritjes se padisë e deri ne ditën e pagesës definitive të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit , nen kërcënim te përmbarimit te dhunshëm .

Pala e paditur te paguaj shpenzimet procedurale te kësaj çështje juridike në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit, nen kërcënim te përmbarimit te dhunshëm .


1.) të bihet :

#### AKTVENDIM

Mbi miratimin e propozimit te paditëses në ter çështjen juridike mbi lirimin nga pagimi i taksave dhe shpenzimeve tjera procedurale duke marr parasysh gjendjen e vështir ekonomike te paditësit ne kuptim me nenin 7 te Udhëzimit Administrativ nga K.GJ. 2008/02 dhe neni 468.1 te Ligji Nr. 03/L-006 .

Skenderaj , me dt. 03.05.2010

Paditësi  
Ajet Kajtazi



Shtojcë :

- 1.Kërkesa për kompensimin e dëmeve te luftës , e dt. 22.12. nr. 580 – 1
- 2.Fletëparaqitja e te dhenave për evidencë për personat e siguruar – Enti i Sigurimit ne Mitrovicë (foto kopje)
- 3.Librezja e punës e përmbyllur me 28.02.1992 (foto kopje)
- 4.Deklarata për bashkësinë familjare Nr. 000193e datës 12-janar-.2009
- 5.Certifikata mbi te drejtat e pronës së paluajtshme UL – 72015062-00294 e dt.15.12/08
- 6.Vërtetimi i Drejtorisë së Urbanizmit nr.325-510 i dt.09.12.2008
7. 4 kopje te padisë